



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 952 Prot.

Tiranë, më 24. 7 2018

VENDIM Nr. 151, datë 18.07.2018

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 7, datë 18.07.2018, pasi shqyrtoi Konceptin e realizimit të sondazheve arkeologjike në kuadër të projektit *"Pikë shitje me pakicë të karburanteve dhe ambiente shërbimi" në rrugën "Hysen Kërtusha", në zonë arkeologjike "B" Durrës*-subjekti "KASTRATI" sh.p.k., paraqitur nga individ i licencuar në arkeologji Z. Eduard Shehi.

VENDOSI:

1. Të miratojë Konceptin e realizimit të sondazheve arkeologjike në kuadër të projektit *"Pikë shitje me pakicë të karburanteve dhe ambiente shërbimi" në rrugën "Hysen Kërtusha", në zonë arkeologjike "B" Durrës*-subjekti "KASTRATI" sh.p.k., paraqitur nga individ i licencuar në arkeologji Z. Eduard Shehi.
2. Subjekti "KASTRATI" sh.p.k., duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të kryejë sondazhin arkeologjik, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETARI KKA
RUDINA ZOTO